



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,16.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.09.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **NNP SHKOZA F 007** ", për aktivitetin: " **Sanimi I gropave dhe deformimeve të asfaltit në rruget dhe trotoret e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 3885 521** nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **NNP SHKOZA F 007** " e datës 14.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Sanimi I gropave dhe deformimeve të asfaltit në rruget dhe trotoret e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 3885 521** kundër njoftimit për anulim të tenderit , të datës 08.09.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj procedurës sipas Njoftimit të datës 08.09.2021
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " **NNP SHKOZA F 007** " me datë 13.09.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sanimi I gropave dhe deformimeve të asfaltit në rruget dhe trotoret e Prishtinës Nr. të Prok: 616 21 3885 521**

**Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar kërkesën me datën 16.09.2021 dhe ka konstatuar si vijon:**

Pretendimet lidhur me sqarimet e dhëna për çmimet jonormalist të ulta janë plotësisht të pa bazuara, pasi që në të njëjtat pretenduesi nuk ka dhënë asnjë zgjidhje të favorshme teknike e as ndonjë dëshmi favorizimin nga ndonjë prodhues i artikujëve të kërkuar. Poashtu edhe argumentet që është mundura t'i paraqes në kërkesën për rishqyrtim janë të nivelit të njëjtë, respektivisht janë vetëm deklarime të pa bazuara në

dëshmi, sepse sikurse të ekzistonin dëshmitë e tilla do të paraqiteshin në ofertën e të njëjtit dhe në përgjegjen lidhur me sgarimet e kërkuara për çmimet jonormalisht të ulta.

**Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.**

**Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.**

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit